



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 182/1 Prot.

Tiranë, më 07.02.2018

V E N D I M

Nr. 48, Datë 07.02.2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa Nr. 16, datë 31.01.2018, e A. R., ku pretendohet për diskriminim *për shkak të gjendjes familjare dhe përkatësisë në një grup të veçantë*¹, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (ish Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë).

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaron se, ka punuar pranë Shtëpisë së Fëmijës Parashkollor 3-6 vjeç Shkodër, në pozicionin e punës si Kujdestar Shtëpi-Familje. Pas pamjeve filmike të shfaqura në Emisionin Investigativ “Ça thu”, në Televizionin Agon Channel më datë 06.07.2015, në të cilat evidentohet keqtrajtimi i të miturve të Shtëpisë së Fëmijës Parashkollor Shkodër nga ana e Kujdestarëve, ankuesi është larguar nga puna. Pavarësisht faktit që ankuesi nuk është ndjekur penalisht, apo nuk ka qënë pjesë e hetimit nga Prokuroria e Rrethit Shkodër, nga ana e punëdhënësit nuk është marrë asnjë masë për rikthimin e tij në punë.

Në përfundim, ankuesi pretendon se punëdhënësi ish Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, sot Ministria së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me anë të procedurës së ndjekur për largimin nga puna dhe mosrikthimin në punë, ka sjellë trajtimin diskriminues të tij, për shkak të *gjendjes familjare dhe përkatësisë në një grup të veçantë*.

¹ Ankuesi i përket komunitetit egjiptian

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Bazuar në formularin e ankesës nr. 16, datë 31.01.2018, si dhe dokumentacionit dërguar në mbështetje të pretendimeve të tij, Komisioneri vlerëson se, A. R. është vënë në dijeni për sjelljen diskriminuese të pretenduar nga ana e ish Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, sot Ministria së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, më datë **07.07.2015**.

Në këto kushte dhe referuar nenit 33 pika 4/dh të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, **për këtë fakt**”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.*

Për sa më sipër, diskriminimi i pretenduar nga A. R., sipas informacionit të dhënë prej tij ka marrë dijeni po në datë **07.07.2015**, ndërkohë që ankesa pranë Komisionerit është paraqitur në datën **31.01.2018**. Në këtë kontekst, rezulton se ankesa është paraqitur pranë KMD-së, më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për diskriminimin e ndodhur. Pra, ankesa është depozituar tej afateve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*.

Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 34, pika 1, subjekti ankues pavarësisht mos pranimit të ankesës, ka të drejtën e ngritjes së padisë në gjykatë pa e lidhur atë me mospranimin e saj nga Komisioneri për shkak të procedurës ligjore.

Më konkretisht, sipas nenit 34, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim, 1: *“Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit,*

të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale”, 2: “Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale”.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 36, pika 1, *Procedura para gjykatës “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijani për këtë sjellje”,* ti drejtoheni gjykatës kompetente për shqyrtimin e kësaj ankese.

PËR KËTO ARSYE:

Nga shqyrtimi i kësaj ankese dhe bazuar në nenin 33, pika 4/dh e Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së A. R., për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Rekomandimin e subjektit ankues që pretendimin për diskriminim, ta ndjekë gjyqësisht, në zbatim të nenit 36, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Irma BARAKU

(Shkaku: Etnia)
(Fusha: Punësim)